



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAÇANIK



Komuna Kaçanik
Skupština Opština
Municipality of Kaçanik

1	Data	15.02.16	Vendi	Kaçanik
	Nj. org.		Numri	Shtojcë
		01 Nr. 16-4996		12016

Në bazë të nenit 14 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr. 28/ 2008), të nenit 3 pika 1 paragrafi 4 lidhur me nenet, 4,6 dhe 7.3 paragrafi 1. i Ligjit Nr.04/L-144, Për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së palujtshme të Komunës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr. 35/17,dhjetor 2012), të nenit 5 të Rregullores QRK 23/2013- Për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfytëzim dhe këmbimit të pronës së palujtshme të Komunës, të nenit 3 të Statutit të Komunës, të Propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës prej dates 08.02.2016, Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e vet të mbajtur me datë, 15.02.2016, merr këtë:

VENDIM
PARAPRAK PËR DHËNIEN E PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS
NË SHFYTËZIM AFATGJATË

1. Me këtë Vendim ipen në shfrytëzim **AFATGJATË**, pronat e paluajtshme të Komunës së Kaçanikut, personave fizik dhe juridik.
2. Pronat e palujtshme për dhënie në shfrytëzim të cekur si në pikën 1. të këtij Vendimi ipen në shfrytëzim në periudhë afatgjatë kohore, për **katërdhjetë (40) vite**, në Zonat Kadastrale si vijon:

2.1. Zona Kadastrale Begracë :

- 2.1.1. Ngastra kadastrale nr. 02706-0 me S=03.93.64 ha,
- 2.1.2. Ngastar kadastrale nr. 02647-0, me S=00.27.64 ha,
- 2.1.3. Ngastra kadastrale nr. 01580-0 me S=02.33.79 ha,
- 2.1.4. Ngastra kadastrale nr. 01579-0 me S=00.64.80 ha.

2.2. Zona kadastrale Doganaj :

- 2.2.1. Ngastra kadastrale nr. 00143-0 me S=04.94.90 ha,
- 2.2.2. Ngastra kadastrale nr. 00124-0 me S=00.46.01 ha.

2.3. Zona Kadastrale Gërlicë e Epërme :

- 2.3.1. Ngastra kadastrale nr. 00215-0 me S=00.28.57 ha,
- 2.3.2. Ngastra kadastrale nr.00217-0, me S=00.94.13 ha.

2.4. Zona kadastrale Kaçanik i Vjetër :

- 2.4.1. Ngastra kadastrale nr. 01407-0 me S=03.47.82 ha,
- 2.4.2. Ngastra kadastrale nr. 01405-0 me S=00.66.28 ha,
- 2.4.3. Ngastra kadastrale nr. 00401-0 me S=03.45.94 ha,
- 2.4.4. Ngastra kadastrale nr. 00402-0 me S=00.95.48 ha,
- 2.4.5. Ngastra kadastrale nr. 00403-0 me S=00.32.99 ha.

3. Pronat e përcaktuara në ngastrat kadastrale të pikës 2. të këtij Vendimi, janë pronë e Komunës Kaçanik.

4. Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronës komunale është; krijimi i kushteve për zhvillim të bizneseve, krijimi i mundësisë për investime nga investitorë vendor dhe të huaj, me ç'rast do të krijohen vende të reja të punës.

5. Me dhënien e pronës komunale në shfrytëzim sipas dispozitave ligjore në fuqi, komuna do të mund të inkason edhe të hyra komunale të cilat do të konsiderohen para publike dhe i nënshtrohen dispozitave ligjore për menaxhimin e financave publike.

6. Procedura për dhënien e pronës së palujtshme të Komunës në shfrytëzim në periudhë afatgjatë do të bëhet përmes, Konkursit të hapur Publik.

6.1. Procedurat e parapara me Ligjin Nr.04/L-144, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së palujtshme të Komunës. dhe me Rregulloren e QRK 23/2013- Për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së palujtshme të Komunës do t'i zhvilloi, Komisioni vlerësues për dhënien në shfrytëzim pronën e paluajtshme të komunës, i formuar me Vendim të Kuvendit të Komunës.

7. Për realizimin e këtij Vendimi do të kujdeset, Kryetari i Komunës.

8. Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokolit të autoritetit mbikqyrës-MAPL, si dhe pas publikimit në faqen zyrtare të komunës.

Vendimi iu dërgohet: MAPL, Komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronave të paluajtshme të komunës, Kryetarit të Komunës, DUKMM, dhe Arkivit.

Kryesuesi i Kuvendit,
Xhelal Gashi

